REPUBLIKA SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr.__23333______Vendimit

23333

**V E N D I M**
( PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK )

Sot me date__9. 3. 2000__une gjyqtar i Gjykates se rrethit Tirane_________mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Nuri Balla i biri i Qamilit,lindur me 1966 ne Peshkopi dhe banues ne lagjen "Partizani" te qytetit te Elbasanit,per rregjistrimin e tij si person juridik dhe

KONSTATOVA

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi Nuri Balla per rregjistrimin e tij si person JURIDIK te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k) me ortak te vetem duke krijuar shoqerine "ERGI " sh.p.k dhe me objekt te veprimtarise se saj:" Ne fushen e ndertimit:kryerjen e veprimtarive ndertimore,ndertime civile,industriale dhe bujqesore dhe cdo punim tjeter qe lejon legjislacioni shqiptar.Prodhim dhe tregtim materialesh dhe elementesh ndertimore.Ne fushen tregtare:Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale,ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar,transport i mallrave dhe i udhetareve,tregtim te plehrave kimike,punime duroalumini, hekuri dhe druri dhe tregtim materialesh duroalumini,hekuri dhe druri, grumbullim dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore".

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit nr.7512 date 10.08.1991,te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit nr.7667 date 28.01.1993

# V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise "ERGI "sh.p.k, me ortak te vetem ,shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe me objekt te veprimtarise se saj: " Ne fushen e ndertimit:kryerjen e veprimtarive ndertimore,ndertime civile,industriale dhe bujqesore dhe cdo punim tjeter qe lejon legjislacioni shqiptar.Prodhim dhe tregtim materialesh dhe elementesh ndertimore.Ne fushen tregtare:Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale,ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar,transport i mallrave dhe i udhetareve,tregtim te plehrave kimike,punime duroalumini, hekuri dhe druri dhe tregtim materialesh duroalumini,hekuri dhe druri, grumbullim dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore".

Shoqeria "ERGI"sh.p.k e ka qendren ne qytetin e Elbasanit lagjia "Partizani",pallati nr.409.

Administrator i shoqerise eshte ortaku i vetem i shoqerise z.Nuri Balla

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke dhe kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise mbi dhjete (10) vjet.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

G J Y Q T A R

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**NR** 23333/1 **vendimit**

# VENDIM
## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 09.05.05, une, gjyqtar i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", per depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit nr.1 date 07.05.2005 te ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise " ERGI "sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 23333 date 08.03.2000 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "ERGI" sh.p.k ,me ortak te vetem , me kapital 100.000 leke, me administrator ortakun e vetem te shoqerise z.Nuri Balla, me seli ne Elbasan, lagjia "Partizani", pallati nr.409.

Me vedimin nr.1 date 07.05.2005 te Ortakut te vetem eshte vendosur

1.Parimisht te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura te shoqerise.

2.Emerimin nga Gjykata per kete qellim te ekspertit kontabel te autorizuar z.Andon Taqo Kristo, me license nr.5.

3. Depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar.

Ne keto kushte kerkoj nga Gjykata miratimin dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrit tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARESYE :**

**Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"**

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1, date 07.05.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise " ERGI " sh.p.k. Emerimin nga Gjykata te ekspertit kontabel te autorizuar z.Andon Taqo Kristo, me license nr.5.--------------------------------------------------------------------------------------

Te behen shenimet perkatese ne Rregjistrin Tregtar .

GJYQTAR
Mariana Tafaj

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**NR.** 23333/2 **vendimit**

**V E N D I M**

**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 17.06.05, une, gjyqtar i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", per depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit nr.1 date 07.05.2005 te ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise " ERGI "sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A SE:

Me vendimin nr. 23333 date 08.03.2000 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "ERGI" sh.p.k ,me ortak te vetem , me kapital 100.000 leke, me administrator ortakun e vetem te shoqerise z.Nuri Balla, me seli ne Elbasan, lagjia "Partizani", pallati nr.409.

Me vendimin nr.1 te dates 07.05.2005 te Ortakut te vetem te rregjistruar ne rregjistrin tregtar me nr.23333/1 vendimi date 09.05.2005 eshte vendosur: 1.Parimisht te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura te shoqerise dhe 2. Emerimin nga Gjykata per kete qellim te ekspertit kontabel te autorizuar z.Andon Taqo Kristo, me license nr.5.

Me vendimin nr.2 date 14.06.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise "ERGI" sh.p.k eshte vendosur:

1. Te miratoje aktin e paraqitur nga eksperti per shtimin e kapitalit.
2. Te shtoje kapitalin e shoqerise nga 100'000 leke ne 14'400'000 leke
3. Numri i kuotave do te mbetet i njejte duke u ritur vlera nominale e nje kuote nga 1'000 leke ne 14'400.00 leke.
4. Depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar.

Ne keto kushte kerkoj nga Gjykata miratimin dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrit tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARESYE :**

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

**V E N D O S A:**

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr.2, date 140.06.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise " ERGI " sh.p.k. mbi rritjen e kapitalit te shoqerise. ------------------------------------------

Te behen shenimet perkatese ne Rregjistrin Tregtar .

**GJYQTAR**
Ariana Coco

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**Nr** 23333/3 **vendimit**

**V E N D I M**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me daten 07/06/2006 Une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane **Blerina Muca,** pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"ERGI" shpk** me Administrator Te Pergjithshem**Z.Nuri Balla**,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitimin e dokumentave te shoqerise,

**V E R E J :**

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr.23333 date 9.3.2000 eshte themeluar shoqeria **"ERGI" shpk** me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.
Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaku i vetem i shoqerise me vendimin Nr.3 date 5.5.2006 ka vendosur :
**1.Fillimin e procedures per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise si kontribute ne natyre ,si rikapitalizim i fitimit te vitit ushtrimor 2005 nga ana e shoqerise.**
**2.Kryerja e aktit te ekspertimit i cili do te evidentoje rritjen e mesiperme dhe caktimin e Zj.Lumturi Brahaj,eksperte kontabel e autorizuar per kryerjen e tij."**
*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

**PER KETO ARSYE**

**Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992**

**V E N D O S A**

*Pranimin e kerkeses.
*Depozitimin e kerkeses,vendimit te ortakut Nr.3 date 5.5.2006,licenses te paraqitura nga shoqeria **"ERGI"** shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

**G J Y Q T A R E**
**BLERINA MUÇA**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**Nr** 23333/4 **vendimit**

**V E N D I M**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me daten 16/06/2006 Une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane **Blerina Muca**, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"ERGI" shpk** me Administrator Te Pergjithshem**Z.Nuri Balla**,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitimin e dokumentave te shoqerise,

**V E R E J :**

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr.23333 date 9.3.2000 eshte themeluar shoqeria **"ERGI" shpk** me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.
Me vendimin nr.23333/3 date 7.6.2006 eshte vendosur :"Fillimi i procedures per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise si kontribute ne natyre,si rikapitalizim i fitimit te vitit ushtrimor 2005 nga ana e shoqerise.Kryerja e aktit te ekspertimit i cili do te evidentoje rritjen e mesiperme dhe caktimin e Zj.Lumturi Brahaj,eksperte kontabel e autorizuar per kryerjen e tij."
Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaku i vetem i shoqerise me vendimin Nr.4 date 12.6.2006 ka vendosur :
**1.Miratimin e raportit te ekspertes kontabel per zmadhimin e kapitalit te shoqerise.**
**2.Miratimin e shteses se kapitalit ne vleren 4.600.000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i shoqerise ne shumen 19.000.000 leke .Pjesmarrja ne kapital nuk ndryshon .Ai zoterohet 100% nga ortaku i vetem Z.Nuri Balla.**
*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

**PER KETO ARSYE**

**Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992**

**V E N D O S A**

*Pranimin e kerkeses.
*Depozitimin e kerkeses,vendimit te ortakut Nr.4 date 12.6.2006,raportit te ekspertit kontabel te paraqitura nga shoqeria **"ERGI"** shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

**G J Y Q T A R E**
**BLERINA MUÇA**

## URDHER – REGJISTRIMI

1 23.333

2 (a) Emertimi: "Orgi" Sh.p.k.

(b) Selia: Elbasan, L. Qendra P.408.

(c) Objekti: Ne fushen e ndertimit, [illegible] e [illegible] [illegible] / [illegible], auto etj.

(ç) Kapitali: 100.000 leke

3.Administrator i shoqerise [illegible] Bella.

4. Statuti eshte nenshkruar me dt. 7. 3. 2000.

5.Regjistruar me dt. 8. 3. 2000.

Mandat Arketimi Nr 70 371 [illegible]

[illegible] N 7. 2087/1

[illegible] dt. 8. 3. 2000

Gjyqtare

[illegible]

# AKTI I THEMELIMIT
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## " ERGI " SH.P.K

Ne baze te ligjit nr.7512 date 10.08.1991,te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit nr.7667 date 28.11.1993 zoti Nuri Balla i biri i Qamilit,lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne qytetin e Elbasanit lagjia "Partizani",pallati 409,themelon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k ) te emertuar "ERGI"sh.p.k.

NENI 1

Shoqeria ka emrin "Ergi" sh.p.k. me ortak te vetem te saj z. Nuri Balla

Administratori i shoqerise "Ergi" sh.p.k eshte ortaku i vetem i saj z.Nuri Balla

NENI 2

Shoqeria " Ergi " sh.p.k gezon statusin e personit juridik.Veprimtaria ekonomike dhe financiare e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te ketij akti themelimi,statutit te saj dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.Statuti i shoqerise i bashkengjitet ketij akti themelimi dhe eshte pjese perbere e saj dhe e dokumentacionit te shoqerise.

NENI 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj ne organet kopetente te shtetit shqiptar dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe mbi dhjete vjet.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e aftatit te parashikuar ne kete akt,nese ortaku i vetem me vullnetin e tij te lire nuk e zgjat kete afat.

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni, nese per kete merr vendim ortaku i vetem i saj ose per pamundesi aktiviteti etj.

NENI 4

Selia e shoqerise "Ergi"sh.p.k do te jete ne Lagjen "Partizani",pallati nr.409 te qytetit te Elbasanit.

Shoqeria mund te hape filiale,dege ,perfaqesi ose agjensi ne varesi te saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise ne cdo kohe qe te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kopetente.

NENI 5

Shoqeria "Ergi" sh.p.k do te kete si objekt te veprimtarise se saj: "Ne fushen e ndertimit:kryerjen e veprimtarive ndertimore,ndertime civile,industriale dhe bujqesore dhe cdo punim tjeter qe lejon legjislacioni

shqiptar.Prodhim dhe tregtim materialesh dhe elementesh ndertimore.Ne fushen tregtare:Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale,ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar,transport i mallrave dhe i udhetareve,tregtim te plehrave kimike,punime duroalumini, hekuri dhe druri dhe tregtim materialesh duroalumini,hekuri dhe druri, grumbullim dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore".

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije)leke dhe i formuar ne masen e tij te plote nga ortaku i vetem i shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqerise depozitohet ne llogarine e shoqerise ne Banke.

NENI 7

Per detyrimet qe mund te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te shoqersie,kjo shoqeri do te pergjigjet vete me kapitalin e saj.

NENI 8

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendime qe merr ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 9

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet ose perfaqesite e ngritura prej saj rregullohen nepermet kontrates se punes dhe Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

NENI 10

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Ky akt themelimi hartohet ne pese kopje te njejta origjinale per t`iu shperndare organeve kopetente ndersa nje kopje mbetet dhe depozitohet si pjese perberese e dokumentacionit te shoqerise.

ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETEM
I SHOQERISE "ERGI" SH.P.K
NURI BALLA

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## **" ERGI " SH.P.K**

## KREU I
## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Ergi"sh.p.k eshte krijuar sipas aktit te themelimit dhe ketij statuti te perpiluar dhe te nenshkruar nga ortaku i vetem i saj:z.Nuri Balla i biri i Qamilit,lindur me 1966 ne Peshkopi dhe banues ne lagjen "Partizani",pallati 409 te qytetit te Elbasanit.

### NENI 2

Emertimi i shoqerise eshte "Ergi" sh.p.k(shoqeri me pergjegjesi te kufizuar).

### NENI 3

Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

### NENI 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Ergi" sh.p.k ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar,rregullon poziten juridike te themeluesit te saj dhe punonjesve ne shoqeri,te dhenat me rendesi per qarkullim juridik,organizimin,objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise dhe veprimtarine e saj.

### NENI 5

Shoqeria "Ergi" sh.p.k eshte person juridik dhe fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne organet perkatese.Shoqeria e ushtron veprimtarine saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj,akti i themelimit dhe ne kete statut.

### NENI 6

Selia e shoqerise "Ergi"sh.p.k eshte ne qytetin e Elbasanit,lagjia "Partizani",pallati nr.409.

### NENI 7

Administratori i shoqerise eshte ortaku i vetem i saj Z.Nuri Balla.

### NENI 8

Shoqeria ka vulen dhe stemen e saj me emerin e shoqerise.

NENI 9

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ekonomike:" Ne fushen e ndertimit:kryerjen e veprimtarive ndertimore,ndertime civile,industriale dhe bujqesore dhe cdo punim tjeter qe lejon legjislacioni shqiptar.Prodhim dhe tregtim materialesh dhe elementesh ndertimore.Ne fushen tregtare:Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale,ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar,transport i mallrave dhe i udhetareve,tregtim te plehrave kimike,punime duroalumini. hekuri dhe druri dhe tregtim materialesh duroalumini,hekuri dhe druri. grumbullim dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore".

NENI 10

Shoqeria e ushtron veprimtarine e vet te percaktuar ne kete statut ne territorrin e Republikes se Shqiperise.Per kryerjen e kesaj veprimtarie dhe zgjerimin e saj shoqeria mund te cele dege ,zyre dhe filiale te saj te perfaqesimit ne te gjithe territorrin e vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 11

Shoqeria e kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likujditetit,sigurise dhe rentabilitetit

NENI 12

Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon themeluesin e saj te kete pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie

NENI 13

Ortaku i vetem i shoqerise ka keto te drejta kryesore:

-Te marre pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin,vete ose nepermjet perfaqsuesit te caktuar prej tij.

-Te marre pjese ne rezultatet e veprimtarise ne cdo forme e sasi qofte,ne perputhje me statutin dhe aktin e themelimit.

-Te marre pjese ne organet e shoqerise qe jane ose qe mund te krijohen nepermjet perfaqsuesit te tij ose vete.

-Te kerkoje ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregetare te shoqerise si dhe te gjithe dokumentat e perpunuara te shoqerise si bilancet ,llogarite ekonomike etj.

-Te beje propozime dhe ti paraqese ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.

-Te emeroje dhe te shkarkoje administratoret,punonjesit,ekspertin kontabel dhe likujdatoret.

-Te heqe dore nga shoqeria duke i ofruar pjese te saj te treteve.Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun e vetem nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj te treteve

NENI 14

Themeluesi ka keto detyra kryesore:

-Te depozitoje kapitalin e tij ne perputhje me aktin e themelimit te shoqerise dhe me ke statut.

-Te marre pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tij,vete ose nepermjet perfaqsuesve te caktuar prej tij.

-Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

## KREU II

### KUSHTET EKONOMIKE

NENI 15

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

NENI 16

Per te bere te mundur zhvillimin e shoqerise prej themeluesit te saj caktohet nje kapital themeltar prej 100.000 leke i formuar teresisht nga ortaku i vetem i saj.

NENI 17

Ortaku i vetem i shoqerise mund te rrise kapitalin e shoqerise dhe ta pasqyroje ate ne regjistrin tregetar.

NENI 18

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare,perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj,por gjithmone ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe ajokryen.

Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale dhe pasurore.Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

NENI 19

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta finaciare.Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve ,nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare qe kur deshiron mund te derdhen prej ortakut te vetem te saj ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

# KREU III

## VITI FINANCIAR,LLOGARITE VJETORE,NDARJA E FITIMIT.

### NENI 20

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar ka fillim me diten e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon me 31 dhjetor te vitit.

### NENI 21

Llogarite vjetore,inventari,raportet e operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga asambleja e shoqerise.Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej gjashte muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

### NENI 22

Fitimi neto realizohet nga shoqeria mbasi te zbriten te gjitha detyrimet si dhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike per investime per reklamen tregetare etj.Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.Ne cdo peridhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqerise me llogarine fitim humbje mbeshtetur ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private te percaktuara nga organet kopetente te sistemit fiskal.

### NENI 23

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes.Bilanci kontabel vjetor i shoqerise miratohet nga ortaku i vetem i cili vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin dhe garancine e veprimtarise se shoqerise.

# KREU IV

## ADMINISTRIMI

### NENI 24

Ortaku i vetem i shoqerise perballon humbjet e saj deri ne kufirine vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar te saj.Ortaku i

vetem mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

NENI 25

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar eshte prone e themeluesit te saj,ajo merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti,te cilat jane te detyrueshme per te gjithe punonjesit e shoqerise.

NENI 26

Ortaku i vetem sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e shoqerise emeron administrator si dhe puneson punonjes te veprimtarive te ndryshme ekonomike sipas objektit te veprimtarise ekonomike te shoqerise.

NENI 27

Ortaku i vetem shoqerise dhe administratori i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloj kufizimi.Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe i konsiderojne te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise.Ata kane te drejte midis te tjerash te blejne e kembejne pasuri,telidhen me shoqerite e tjera te vendit ose te huaja ,te kryejne cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave private ose shteterore qe kane te bejne me garancite ,ipotekat dhe veprimtarine ekonomike dhe financiare te shoqerise etj.Ortaku i vetem i shoqerise dhe administratori i caktuar prej tij kane te drejte te kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi ,kreditimi,pagesa dhe arketime .Ne keto raste administratori i ngarkuar ka per detyre te ngarkoje,te njoftoje e t`i jape llogari ortakut te vetem.

NENI 28

Perfaqsimi i shoqerise i perket ortakut te vetem dhe administratorit te ngarkuar .Ata kane te drejten e perfaqsimit te shoqerise ne Organet gjyqesore dhe administrative ,te caktoje dhe te pushoje avokat.

## KREU V

### KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 29

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe.Shoqeria mund te ndryshoje emerin,seline si dhe objektine veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem i saj.

# K R E U VI

## MARREDHENIET E PUNES

### N E N I 30

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me aktine themelimit per krijimin e shoqerise,legjislacionin shqiptar dhe me kete statut.

### N E N I 31

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes,puna e nates,puna jashte kohes normale,puna ne ditet e pushimit javor dhe festave zyrtare .

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat,te drejtat,detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes,

Paga e punes se punonjesit,shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Marredhenie te tjera te punes rregullohen ne baze te Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise.

### N E N I 32

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### N E N I 33

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mundte lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata.

# K R E U VII

## MBYLLJA E SHOQERISE

### N E N I 34

Shperberja ose mbyllja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku si humbja e kapitalit,pamundesi veprimtarie etj.Ne keto

raste ortaku i vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore.Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo ka ndaj personave te trete fizike dhe juridike.Shoqeria i jep fund veprimtarise ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit te hartuar nga likujdatoret dhe ekspertet e miratuar.

## KREU VIII
## DISPOZITA TE FUNDIT
### NENI 35

Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahet ne seline e shoqerise.

### NENI 36

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve nga ortaku i vetem dhe ligjeve perkatese shqiptare

### NENI 37

Ky statut perpilohet ne pese kopje te njejta origjinale per tiu shperndare organeve kompetente ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te shoqerise.

ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETEM
NURI BALLA

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN
Nr. 2063 rep.

Elbasan me 07.03.2000

## VERTETIM

Ne Elbasan sot me date 07.03.2000 ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan para meje noteres Majlinda Lato u paraqit personalisht shtetasi shqiptar z.Nuri Balla i biri i Qamilit,lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne lagjen “Partizani” te Elbasanit, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike,i njohur nga une noteria ne baze te dokumentit identifikues qe me paraqiti i cili aktin e mesiperm e nenshkroi me vullnet te lire dhe me doren e tij ne pranine time noteres dhe une noteria e vertetoj konform ligjit dhe sipas tij.

NOTERE
MAJLINDA LATO






**REPUBLIKA SHQIPERISE**
**AVOKATIA E RRETHIT**
**E L B A S A N**

**Elbasan me 07.03.2000**

# *K E R K E S E*

**K E R K U E S I:Nuri Balla i biri i Qamilit lindur me 1966 ne Peshkopi dhe banues ne lagjen "Parizani"te Elbasanit.**

**O B J E K T I** :Kerkoj te miratohem dhe te rregjistrohem si person juridik ne krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar(sh.p.k) **" Ergi "** me qender ne Elbasan ne baze te ligjit nr.7512 date 10.8.1991,te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit nr.7667 date 28.01.1993.

P E




Z.Kryetar!

Paraqes kerkesen per t'u rregjistruar si person juridik ne krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Ergi"sh.p.k.

Qendra e shoqerise eshte ne Elbasan ne lagjen "Partizani",pallati 409,me nje kapital themelues prej 100.000 (njeqindmije)leke.

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte:" Ne fushen e ndertimit :kryerjen e e veprimtarive ndertimore,ndertime civile,industriale dhe bujqesore dhe cdo punim tjeter qe lejon legjislacioni shqiptar.Prodhim dhe tregetim materialesh dhe elementesh ndertimore.Ne fushen tregetare:import-eksport dhe tregetim me shumice dhe me pakice te te gjithe mallrave industriale ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar,transport i mallrave dhe i udhetareve,tregetim te plehrave kimike,punime duroalumini,hekuri dhe druri dhe tregetim materialesh duroalumini,hekuri dhe druri,grumbullim dhe tregetim i i bimeve medicinale dhe eterovajore".

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte mbi dhjete vjet.

Shoqeria "Ergi"sh.p.k perbehet nga nje ortak i vetem dhe administrator i shoqerise eshte ortaku i vetem i saj z. Nuri Qamil Balla.

KERKUESI
Ortak dhe administrator i vetem
**NURI QAMIL BALLA**

SHOQERIA

" ERGI "

BANKA E KURSIMEVE sh. a.

DEGA BANKËS KURSIMEVE ELBASAN me 7.03.2000

**V Ë R T E T I M**

Me anën e të cilit vërtetojmë se Z. Nuri Balla është klient i Degës Bankës Kursimit Elbasan dhe ka Nr. llogarie 573/27/2 100.000 lekë (njëqind mijë lekë)

REPUBLIKA E SHQIPERISE DEGA E BANKES SE KURSIMEVE ELBASAN

Benon Agolli
DREJTORI DEGËS

Parashqevi Dhima
EKONOMISTE

... kredituar ne llogari jane te pranueshme nga Banka e Kursimeve me rezerve per verifikim. Kur ato kthehen pa ... debitohen me iniciative llogarine e perfituesit. Ne rast mungese te gjendjes ne llogari perfituesi detyrohet ti ktheje menjehere Bankes shumen perkatese, kundrejt kerkeses se thjeshte te saj.

341/05

... me license nr.5 .

3. Depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar.

ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETEM

Nuri Balla

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE Elbasan
NR. 3748 REP.

TAKSA E PULLES U NKUJDUA

## VERTETIM

Sot me date 07.05.2005, para meje noterit publik Majlinda Lato me seli ne Elbasan, lagjia 5 Maj u paraqit personalisht z. **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", sh.p.k, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise " ERGI " sh.p.k. i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERI PUBLIK**

Majlinda Lato

SHOQERIA

" ERGI " sh.p.k.

# VENDIM

## NR. 2, DATE 14.06.2005

Sot me date 14.06.2005 ortaku i vetem i shoqerise " ERGI " sh.p.k. pasi mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj ne te ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin

## VENDOSI:

1. Te miratoje aktin e paraqitur nga eksperti per shtimin e kapitalit.
2. Te shtoje kapitalin e shoqerise nga 100'000 leke ne 14'400'000 leke
3. Numri i kuotave do te mbetet i njejte duke u ritur vlera nominale e nje kuote nga 1'000 leke ne 14'400.00 leke.
4. Depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar.

ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETEM

Nuri Balla

**REPUBLIKA SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE Elbasan**
**NR. 4636 REP.**

TAKSA E PU
U LIKUJDUA

# VERTETIM

Sot me date 14.06.2005, para meje noterit publik Majlinda Lato me seli ne Elbasan, lagjia 5 Maj u paraqit personalisht z. **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", sh.p.k, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise " ERGI " sh.p.k. i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERI PUBLIK**

Majlinda Lato

Shoqeria **"ERGI "** shpk
Me seli ne Tirane

**V E N D I M**
**I ORTAKUT TE VETEM**
**Nr. 3 date 5.5.2006**

Sot me daten 5.5.2006 u mblodh shoqeria ***"ERGI"*** me ortak te saj:
Z.Nuri Balla me 100 % te kuotave te kapitalit.

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr.23333 date 9.3.2000 eshte themeluar shoqeria **"ERGI" shpk** me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise nr. 3 date5.5.2006 shoqeria

**V E N D O S I :**

**1.Fillimin e procedures per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise si kontribute ne natyre ,si rikapitalizim i fitimit te vitit ushtrimor 2005 nga ana e shoqerise.**
**2.Kryerja e aktit te ekspertimit i cili do te evidentoje rritjen e mesiperme dhe caktimin e Zj.Lumturi Brahaj,eksperte kontabel e autorizuar per kryerjen e tij."**

*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane .

**Vendimi i mesiperm merret nga ortaku, bazuar ne nenet perkatese te statutit te shoqerise, si dhe te Ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"**

**O R T A K U I S H O Q E R I S E**

**NURI BALLA**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Notere Mimoza Shehu**
**Nr. 6573 Rep.**
**Nr. 1144 Kol**

## V E R T E T I M

Sot me daten 3/6/.2006 ne zyren e Noterise Tirane,perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht ortaku i shoqerise i cili deklaroi se sa siper eshte deklarim i vullnetit te tij e nenshkroi ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.

Notere
Mimoza Shehu

REPUBLIA E SHQIPERISE
SHOQERA TREGTARE " E R G I " sh.p.k.
ASAMBLEA E ORTAKEVE

VENDIM

NR.4 date 9.6....2006

E mbledhur sot date .8.:.6.:..2006.Asamblea e ortakeve te shoqeris "E RGI . "sh.p.k. Elbasan, mori ne shqyrtim rraportin e vecante te Ekspertes kontabel te autorizuar zj.Lumturi Brahaj mbi shtesen e kapitalit te shoqerise tone dhe pasi e diskutoj ate ne perputhje me ligjin nr.7638 date19.12.1992 "Per shoqerite tregtare." dhe statutin e shoqerise :

VENDOSI

1-Miratimin e Rraportit te vecante per vlersimin e kapitalit.
2- Miratimin e shteses se kapialit ne vleren 4 600 000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali nenshkruar I shoqerise ne shumen 19 000 000 leke.
Pjesmarja ne kapital nuk ndryshon.Ai zoterohet 100 % nga ortaku Nuri Balla .
Rritja e kapitalit ka ardhur nga rezervat e mbartura deri ne fund te vitit 2004 dhe fitimin e vitit ushtrimore 2005

3-Depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregetare.

ORTAKU I VETEM

- Nuri Balla-

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
NR. 8171 REP. 1881 kol

Taksa e Pullës u pagua

VERTETIM

Sote me date, 11. 6 .2006, para meje noteterit K. Shala me seli ne Rr. A. Frasheri U paraqite personalishte si me poshte :
Z. Muri Bolla , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,per identitetin e te cilit u siguriva nga dokumentet e indentifikimit, te cilet u nenshkruan ne prezencen time aktin e me siperm dhe une noteri e vertetoje ne baze te ligjit nenshkrimin e tyre.

NOTERE

# KERKESE

**KERKUESI** : z. **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te vetem te shoqerise " ERGI " sh.p.k

**Objekti** : Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr 1 date 07.05.2005 te ortakut te vetem te shoqerise "ERGI" sh.p.k

**PERPARA**

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

**TIRANE**

Me vendimin nr. 23333 date 08.03.2000 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "ERGI" sh.p.k ,me ortak te vetem , me kapital 100.000 leke, me administrator ortakun e vetem te shoqerise z.Nuri Balla, me seli ne Elbasan, lagjia "Partizani", pallati nr.409.

Me vendimin nr.1 te dates 07.05.2005 te Ortakut te vetem eshte vendosur:

1. Parimisht te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura te shoqerise.
2. Emerimin nga Gjykata per kete qellim te ekspertit kontabel te autorizuar z.Andon Taqo Kristo, me license nr.5.
3. Depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar.

Ne keto kushte kerkoj nga Gjykata miratimin dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrit tregtar.

**KERKUESI**

**Nuri Balla**

**Ortak dhe administrator i vetem**

**i shoqerise " ERGI " sh.p.k**

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE Elbasan
NR. 3749 REP.

# VERTETIM

Sot me date 07.05.2005, para meje noterit publik Majlinda Lato me seli ne Elbasan, lagjia 5 Maj u paraqit personalisht z. **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", sh.p.k, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise " ERGI " sh.p.k. i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.




**NOTERI PUBLIK**

Majlinda Lato

Nr 1512 9.3.2000
VERTETIM
Vërtetohet se ... është e njëjtë me ... dokumenti

Z.2087/1

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE.

7/11/2000

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGRON PEZA NOTER ELBASAN

BULETA TAKSE 50 LEKE R. E SHQIPERISE

L I C E N S E.

Z. Haxhi Avdi Gjini, lindur me 04.02.19.., ne Elbasan, me profesion inxhinier ndertimi, diplomuar ne vitin 1974 ne Fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit, dega ndertim, banues ne Elbasan.

Ne baze te kerkeses dhe te dhenave disponibe i jepet license per zbatim dhe regjistrohet ne regjistrin themeltar ... zbatimit qe nga data 25.11.1998 per kategorite e specifikuara te punimeve:

Per zbatim:

Kat. 1 - Punime dheu, sistemime, terracime terrenesh

Kat. 2 - a, c, g.

Kat. 3 - Ndertime civile dhe ekonomike.

Kat. 8/b - ndertim ujesjellesa e kanalizime.
c - ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese.
g - punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik.

Kat. 10/a - rikonstruksione godina civile e ekonomike, veshje fasadash, etj.

KUJTIM BEJTAJ

Zv.M I N I S T E R

REPUBLIKA SHQIPERISE · DHOMA E NOTEREVE · Nr 1511 Rep · Dt 8.3.2000 · VERTETIM · Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin e dokumentit · NOTER

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE
Nr. 1865 rep.
Nr. 310 kol.

Elbasan me 8/3/2000

KONTRATE PUNE

Sot me date 8/3/2000 para meje noterit u paraqiten personalisht shtetasit shqiptare,me cilesite e meposhteme:

PUNEDHENESI: Nuri Balla i biri Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan,ne lagjen "Partizani", pallati 409,ne cilesine e Administratorit te shoqerise "Ergi'' sh.p.k me qender ne Elbasan.

PUNEMARRESI: Haxhi Gjini i biri i Avdiut, lindur me 04.02. 1949 dhe banuese ne Elbasan, me profesion ing.ndertimi i licensuar nga komisioni i dhenies se licensave profesionale ne Ministrine e Ndertimit.

Qe te dy jane madhore dhe te afte per te kryer veprime juridike,te njohur nga une noteri ne baze te dokumentave identifikues qe me paraqiten te cilet me kerkuan redaktimin e ketij akti si vijon.-------------------

1. Punedhenesi Nuri Balla pranon te marre ne pune punemarresin Haxhi Gjini ne specialitetin qe ka si drejtuese teknike ne shoqerine "Ergi" sh.p.k.,me seli ne Elbasan.
2. E drejta e punesimit do te filloje nga data e licensimit te aktivitetit te shoqerise dhe regjistrimit ne organet tatimore te rrethit te Elbasanit.
3. Paga mujore ne etapen e pare te aktivitetit te shoqerise do te jete 10.000 leke. Ne te ardhmen do te rishikohet ne marreveshje midis paleve.
4. Punedhenesi merr persiper te beje rregjistrimin ne organet e Sigurimeve shoqerore per vjetersine ne pune dhe per sigurimin shendetesor.
5. Punemarresi gezon te drejten e tre javeve pushim ne vit te paguesh me nga ana e shoqeriase "Ergi"sh.p.k.
6. Punemarresi gezon te drejtat e percaktuara ne Kodin e Punes ne Republiken e Shqiperise.
7. Sipas kushteve qe mund te lindin kesaj kontrate mund t'i behen shtesa qe te perputhen me interesat e paleve.

Mbi sa me siper u redaktua ky akt ne tre kopje te njejta origjinale iu lexua paleve ne kontrate te cilet si e gjeten konform vullnetit te tyre te lire me doren e tyre e nenshkruan ne pranine time noterit dhe se fundi u nenshkrua dhe nga une noteri konform ligjit.

| PUNEMARRESI | PUNEDHENESI | NOTER |
| --- | --- | --- |
| Haxhi Avdi Gjini | Shoqeria "Ergi" sh.p.k | Agron Peza |
| | ADMINISTRATOR | |
| | NURI BALLA | |



# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE
# (IEKA)



# L I C E N S E

Kjo license i leshohet , ANDON TAQO KRISTO

per te ushtruar profesionin e **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR .**

Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A . dhe mban numrin: 5 , sipas kesaj liste.

**PRESIDENTI**

(BAKI BERBERI)

Berberi

REPUBLIKA E SHQIPERISE INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR

Leshuar me: 10.02.2000

23333/2 S. Ariana Ceco 17 2005 2005

Elbasan me 14.06.2005

**KERKESE**

**KERKUESI** : z. **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te vetem te shoqerise " ERGI " sh.p.k

**Objekti** : Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr 2 date 14.06.2005 te ortakut te vetem te shoqerise "ERGI" sh.p.k

**PERPARA**

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

**TIRANE**

Me vendimin nr. 23333 date 08.03.2000 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "ERGI" sh.p.k ,me ortak te vetem , me kapital 100.000 leke, me administrator ortakun e vetem te shoqerise z.Nuri Balla, me seli ne Elbasan, lagjia "Partizani", pallati nr.409.

Me vendimin nr.1 te dates 07.05.2005 te Ortakut te vetem te rregjistruar ne rregjistrin tregtar me nr.23333/1 vendimi date 09.05.2005 eshte vendosur: 1.Paraprisht te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura te shoqerise dhe 2. Emerimin nga Gjykata per kete qellim te ekspertit kontabel te autorizuar z.Andon Taqo Kristo, me license nr.5.

Me vendimin nr.2 date 14.06.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise "ERGI" sh.p.k eshte vendosur:

1. Te miratoje aktin e paraqitur nga eksperti per shtimin e kapitalit.
2. Te shtoje kapitalin e shoqerise nga 100'000 leke ne 14'400'000 leke
3. Numri i kuotave do te mbetet i njejte duke u rritur vlera nominale e nje kuote nga 1'000 leke ne 14'400.00 leke.
4. Depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar.

Ne keto kushte kerkoj nga Gjykata miratimin dhe depozitimin e ketij vendimi prane regjistrit tregtar.

**KERKUESI**

**Nuri Balla**

**Ortak dhe administrator i vetem**

**i shoqerise " ERGI " sh.p.k**

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE Elbasan
NR. 4637 REP.

## VERTETIM

Sot me date 14.06.2005, para meje noterit publik Majlinda Lato me seli ne Elbasan, lagjia 5 Maj u paraqit personalisht z. **Nuri Balla** i biri i Qamilit, lindur me 12.12.1966 ne Peshkopi dhe banues ne Elbasan lagjia "Partizani", sh.p.k, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise " ERGI " sh.p.k. i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERI PUBLIK**
Majlinda Lato

SHOQERISE „ERGI" SHPK
LAGJA "Partizani"

ELBASAN

----------

RAPORT I
EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR
PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR

Me vendimin Nr.1, date 16.05.2005 te ortakut te vetem te shoqerise „Ergi" shpk Elbasan, eshte vendosur rritja e kapitalit themeltar edhe per 14.300.000.- leke

Kapitali themeltar i i rregjistruar ne gjykate me Vendimin nr.23333, date 30.06.2000 ka qene 100.000.-Leke.

Eshte bere vendimi per rritjen e kapitalit themelor nga ortaku i vetem per 14.300.000.- Leke, keshtu qe kapitali themelor do te arrije shumen totale prej 14.400.000.-Leke.

Une eksperti kontabel i shoqerise kam nderin te raportoj per ekzekutimin e misionit per zmadhimin e kapitalit. Misioni konsiston ne vleresimin e vlerave te pasurise qe perbejne aktivin e shoqerise,si dhe verifikimin qe shuma e kapitaleve te veta eshte te pakten barazi me ato te kapitalit themeltar.

Per kryerjen e ketij misioni une kam pasur ne dispozicion bilancin kontabel te shoqerise te mbyllur me 31.12.2004, date e mbylljes se ushtrimit te fundit, si dhe dokumenta te tjera te nevojshme per kontrollin e ketyre elementeve te ketij bilanci. Kontrolli nga ana ime u krye ne seline e shoqerise ne Lagjen "Partizani", Elbasan ku hartohet bilanci dhe dokumentat kontabel dhe na u dhane spjegime dhe dokumenta justifikues per elementet e e bilancit te shqyrtuar si dhe per evoluimin e situates se shoqerise suaj qysh nga data e mbylljes se ushtrimit financiar te fundit.

Ne baze te hapave te ndermarre dhe te punes se kryer, une jam ne gjendje tu bej te njohur perfundimet qe vijojne ne kuadrin e raportit te parashikuar nga ligji.

A-VLERA E PASURISE QE PERBEJNE AKTIVIN E SHOQERISE

Per shkak te natyres se operacionit te projektuar misioni im i verifikimit konsiston nevojshmerisht per te vleresuar jo aq peshen (rendesine,materialitetin) e plus vlerave eventuale te fshehta (latente) se sa per tu siguruar qe vlerat kontabile per te cilat ortaku i vetem ka marre nje vendim nuk çojne,ne fakt, ne nje mbivleresim te pasursie se shoqerise.

Aktivi i shoqerise i pasqyruar ne bilanc perbehet nga elementet qe vijojne:

| | | |
|---|---|---|
| Aktive te qendrueshme | 7334626.- | leke |
| Aktive qarkullese | 44713205.- | „ |
| Diferenca konvertimi aktive | 861000.- | " |
| | ------------- | |
| Shuma e aktivit | 52908831.- | Leke. |
| Detyrimet: | | |
| Detyrime te kerkueshme pas me shume se nje vit | 3931636.- | |
| Detyrime te kerkueshme deri ne nje vit | 34526287.- | |
| Shuma: | 38457923.-Leke | |

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR ANDON KRISTO ELBASAN

Shuma e aktivit kontabel neto para zmadhimit te kapitalit rezulton:
( 52908831-38457923)= 14450908.-Leke.

Shume qe perbehet:

| | |
|---|---|
| Kapitali i neshkruar | 100000.- |
| Rezerva ligjore | 10000.- |
| Fitime te mbartura | 8729925.- |
| Fitime te ushtrimit | 5610983.- |

Vlersimi i çdo posti te aktivit e pasivit te bilancit ka qene objekt i nje shqyrtimi te vemendshem ne kushtet e paraqitura me poshte:

AKTIVET E QENDRUESHME

Aktivet e trupezuara. Jane detajuar sipas aneksit te bilancit 31.12.2004. Ato jane paraqitur me koston e tyre historike dhe te amortizuara sipas ligjit nr.8438, date 28.12.1998 me nje vlere neto prej ........................................................ 7334626.- leke.
Jane te dokumentuara dhe prone e shoqerise.
Vlera e aseteve te shoqerise i pergjigjet vleres kontabile te tyre ne kontabilitet.

AKTIVET QARKULLUESE

Aktivet qarkulluese perbehen :

| | |
|---|---|
| Kerkesa mbi debitoret | 39210977.- |
| Likuiditete | 5502228.- |
| Shhuma: | 44713205 .- Leke. |

Kekresa mbi debitoret jane te rakorduara e te kuadruara dhe jane te arketueshme, duke perbere nje aktiv real per shoqerine.
Likujditetet te pasqyruara ne bilanc rezultojne te perputhura me ekstratet e bankes 31.12.2004 si dhe gjendjen e arkes ne kete date.

LLOGARI TE TJERA

Diferenca konvertimi aktive 861000. -Leke

Edhe keto jane llogaritur realisht per gjnedjen e yre ne fund te vitit.

DETYRIMET

Ne verifikimin e kryer ne rubrikat e posteve te bilancit detyrimet perbehen nga:

| | |
|---|---|
| Detyrime te kerkueshme per me shume se nje vit | 3931636.- |
| Detyrime te kerkueshme deri ne nje vit | 34526287.- |
| Shuma : | 38457923.- Leke. |

Verifikimi i detyrimeve nuk ka nxjerre asgje jonormale, duke pasur parasysh se deri ne nderhyrjen tone nuk morem dijeni per ndonje konflikt ose rrezik te mundshem per te ndryshuar situaten e shoqerise.

PERFUNDIMI

Ne perfundim te verifikimeve te bera duke pasur parasysh hollesite e dhena me siper une e çmoj se vlera kontabel neto e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise , ashtu sic dalin keto vlera nga pasqyrat financiare qe i jane aneksuar ketij raporti, jane ne pajtueshmeri me rregullat dhe parimet kontabel ne fuqi dhe perbejne nje vleresim normal dhe te arsyeshem.

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
ANDON KRISTO
ELBASAN

B. KAPITALET E VETA DHE KAPITALI THEMELTAR

Per percaktimin e vleres se zmadhimit te kapitalit themeltar eshte ndjekur metoda e vleres neto kontabel, qe llogaritet nga aktivi real duke zbritur detyrimet aktuale te saj.

| | | |
|---|---|---|
| Aktivet kontabel neto | 52908831.- | |
| Detyrimet aktuale | 38457923.- | |
| Kapitalet e veta | 14450908.- | Leke. |

| | |
|---|---|
| Sa me siper kapitali i regjistruar ne gjykate | 100.000.- |
| Rezerva ligjore | 10.000.- |
| Zmadhim kapitali me vendim nr.1, date 16.05.2005 | 14.300.000.- |

Shuma e kapitalit mbas vendmit te ortakevet per zmadhim prej 14.300.000.-leke, arrin 14.400.000.- Leke. (Katermbedhjetemiljonekaterqinmije).
Ndersa shuma 40908.- leke te kaloje rezerve ligjore.

KONLUZION

Kapitali i neneshkuar i shoqerise me vendim gjykate Nr.23333, date 30.06.2000 eshte 100.000.- Leke. Me vlersimin tone ne baze te vendimit nr.1, date 16.05.2005 te ortakut te vetem edhe per 14.300.000.-leke, ***arrin 14.400.000.- Leke.***
Per te qene ne pajtim me ligjin ne vertetojme se shuma e kapitaleve te veta te shoqerise ,e çmuar ne baze te dokumentave per gjendjen 31.12.2004 te cilat na u komunikuan dhe ne i verifikuam, eshte me e larte nga ajo e kapitalit themeltar te shoqerise „ERGI" shpk e percaktuar me vendimin e gjykates nr.23333, date 30.06.2000

Elbasan,me_______________

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR licenca nr.05
(Andon Kristo )

Adersa:
Rruga Rinia, Nr.108 Elbasan
Telefon: 0545-3338
Mob. 0682153419
e-mail: akristot@yahoo.com

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR ANDON KRISTO ELBASAN

SHQERIA "ERGI" SHPK
LAGJA "PARTIZANI"
ELBASAN

**Lista e aktiveve per rritjen e kapitalit te shoqerise**

Per rritjen e kapitalit me burim financimi fitimin e realizuar te shoqerise "ERGI" shpk LAGJA "PARTIZANI", Elbasan, shoqeria ka keto aktive :

| | |
|---|---|
| Aktive te trupezuara | 7334626 Leke |
| Kekresa per arketim | 39210977 Leke |
| Likujditete | 5502228 Leke |
| Diferemca konvertimi aktive | 861000 Leke |
| Shuma | 52908831 Leke |
| Zbriten detyrimet aktuale | 38457923 Leke |
| | |
| Kapitalet e veta | 14450908 Leke |

Prej tyre kapitali themeltar i rregjistruar 100000 Leke
Rezerva ligjore 10000 Leke
**Rritja e re e kapitalit 14.300.000.- Leke, kurse 40908 leke te kaloje ne rritje te rezerves ligjore.**

**Elbasan,me_______________**
Eksperti kontabel i autorizuar lic. Nr.05
(Andon Kristo)

adresa:
Rruga Rinia, nr.108 Elbasan.
Tel 0545-3338
Mob.0682153419
e-mail: akristot@yahoo.com

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR ANDON KRISTO ELBASAN

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN — Elbasan me 15.06.2005
Nr. 4655/ Rep.

TAKSA E PULLES U LIKUJDUA

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 15.06.2005 ne Elbasan ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqit personalisht z. **Andon Kristo** i biri i Taqit ,lindur me 02.10.1948 ne Korçë dhe banues ne qytetin e Elbasanit, me cilesine e ekspertit kontabel te autorizuar me nr.license 5, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike , i cili dokumentin e mesiperm deklaroi se e ka hartuar vete dhe e nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire ne pranine e noteres.U vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit.

N O T E R E
MAJLINDA LATO

## KERKESE

**KERKUES**: Shoqeria"***ERGI*** ***"shpk*** ,e perfaqesuar nga Administratori i saj Z.Nuri Balla, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i njohur personalisht prej meje Noteres.

**OBJEKT:** Depozitimin e dokumentave te shoqerise ***"ERGI " shpk*** ne mbeshtetje te Ligjit 7667 dt. 28 janar 1993.

**PERPARA: GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR**
**T I R A N E**

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr.23333 date 9.3.2000 eshte themeluar shoqeria **"ERGI" shpk** me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.
Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaku i vetem i shoqerise me vendimin date 5.5.2006 ka vendosur :
**1.Fillimin e procedures per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise si kontribute ne natyre ,si rikapitalizim i fitimit te** Vitit ushtri-mor 2005 **nga ana e shoqerise.**
**2.Kryerja e aktit te ekspertimit i cili do te evidentoje rritjen e mesiperme dhe caktimin e Zj.Lumturi Brahaj,eksperte kontabel e autorizuar per kryerjen e tij."**

Sa siper i kerkoj Gjykates:
Te pranoj kerkesen per depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit te ortakeve te shoqerise **"ERGI "** shpk.
Bashkelidhur kerkeses jane:
1.Vendimi i Ortakeve te Shoqerise.
2.Licensa

**K E R K U E S**
***Administratori i Shoqerise***
**Nuri Balla**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Notere Mimoza Shehu**
**Nr.** 1305 **Rep.**

**V E R T E T I M**

Sot me daten 16.5.2006, ne zyren e Noterise Tirane,perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht Z.Nuri Balla me cilesine e administratorit te shoqerise i njohur personalisht prej meje i cili deklaroi se sa siper eshte nje kerkese e redaktuar sipas vullnetit te tij e nenshkroi ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

Notere Mimoza Shehu
Tel.: (04) 232 453, (04) 227 125

# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE (IEKA)



# LICENSE

*Kjo license i leshohet ,* Zj. LUMTURI SINAN BRAHAJ

*per te ushtruar profesionin e* **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR .**

*Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A . dhe mban numrin:* 121 *, sipas kesaj liste.*

**SEKRETARI**

(JORGJI BOLLANO)

**PRESIDENTI**

(BAKI BERBERI)

*Leshuar me,* 10. 01. 2001

**Republika e Shqiperise**
**Dhoma e Noterise Tirane**
**Notere Mimoza Shehu**
**Nr. 6125 Rep**

## Vertetim

Vertetoj se sot me daten 2/6 2006, ne kete zyre Noteriale u paraqit personalisht Zj.Lumturi Brahaj,banuese ne Tirane, identifikuar nga dokumenti qe mbante me vete,e cila kerkoi vertetimin me origjinalin te licenses nr.121 dt.10.1.2001 dhe une noterja si e verifikova me origjinalin vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin dhe e vertetoj sipas ligjit

Notere
Mimoza R.Shehu

23333/4

3 · B. Kuca
11.06.2006

12 QERSHOR 2006

KERKESE

KERKUSI Zt Nuri Balla, lindur me 1966 ne Prshkopi
Dhe banuse ne Elbasan , administratore i Shoqerise "ERGI."sh.p.k .

OBJEKTI Depozitimi ne regjistrin tregtare te vendimit nr4 date 08.06.2006,e te Vendimit nr.4 date 8.6.2006 te Asamblese se ortakeve te shoqeris "ERGI." sh.p.k Elbasan

**GJYKATES SE RRETHIT**

**TIRANE.**

Me vendimin nr.23 333 dt .09.03.2000 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "ERGI "sh.p.k. me seli ne Elbasan.

Me vendimin nr 4 date 8.6.2006 asambleja e ortakeve ka vendosur :

1-Miratimin e rraportit te rritjes se Kapitalit.
2- Miratimin e shteses se kapitalit ne vleren 4 600 000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali I shoqerise ne shumen 19 000 000 leke.
3- Depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtare.

Ne keto kushte kerkoje depozitimin e ketyre vendimeve ne rregjistrin tregetar.

Tirane me, 08.06.2006.

Te depozitohet dt. 16.06.06
Vendimi nr 4 dt 8.6.06
Ortakeve Vetem
Raport Ekspertimi

ADMISTRATORE
-Nuri Balla -

NDERTIM - MONTIM - PROJEKTIM
imp - exp
"ERGI" sh.p.k.
ELBASAN - ALBANIA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Notere Mimoza Shehu**
**Nr.** 6348 **Rep.**
**Nr.**________**Kol**

PULLE TAKSE
REPUBLIKA E SHQIPERISE
100 LEKE

**V E R T E T I M**

Sot me daten 08.06.2006, ne zyren e Noterise Tirane,perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht Z.Nuri Balla me cilesine e administratorit te shoqerise i njohur personalisht prej meje i cili deklaroi se sa siper eshte nje kerkese e redaktuar sipas vullnetit te tij e nenshkroi ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.

Notere
Mimoza

INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR
EKSPERTE :Lumturi Brahaj .Rruga "Don Bosko Tirane, Pallatet Hawai kulla 1,Ap 7/2,
telefon 262 234. dhe 0692158344.
Kodi Fiskal :3910684,NIPT 3910684.

**RAPORT I VECANTE**

**MBI RRITJEN E KAPITALIT TE NENSHKRUAR TE
" E R G I " SH.P.K.**

ELBASAN .

Ne cilesine e Ekspertes Kontabel te Autorizuar e ngarkuar nga gjykata Tirane per verifikimin dhe vertetesine e shteses se kapitalit te shoqerise se me siperme ,paraqes rraportin tim si me poshte.

Shoqeria "E R G I "sh.p.k. eshte krijuar me vendimin nr 23333 aktit,date 09.03.2000 te Gjykates se rrethit Tirane.
Kapitali nenshkruar I saje eshte 14 400 000 leke.

Per sa me siper jane bere rregjistrimet ne regjistrin tregetare.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saje nje hapesire te gjere veprimi ne fushen e ndertimeve te ndryshme ,ne fushen e prodhimit e tregtimit te materjaleve te ndertimit si dhe import eksport e tregti me shumice e pakic te gjiths llojeve te tjeta te mallrave.

Aktualishte ne bilacin e saj "ERGI" sh.p.k. ka rezerva e fitime te pa shperdara , te cilat jane krijuar gjate veprimtarise se saj per te cilat asambleja e ortakeve ka vendosur ti shtoje ne kapital.

Per kryerjen e misionit qe mu ngarkua per vertetimin e shteses se kapitalit te nenshkruar,une ne perputhje me normat profesionale jame mbeshtetur ne dokumentat e me poshteme:

-Bilanciet e shoqerise deri ne fund te vitit 2005.
-Rraportet e auditimit te ketyre bilanceve.
-Ne dokumentat ligjor te shoqerise.
-Ne vendimin e asamlese se Ortakeve per shtesen e kapitalit te shoqerise.

*Nga shqyrtimi I dokumentave kontabel dhe inventarve te fund vitit 2005 ,rezulton se se pasqyrimi I pasurise se shoqerise ne bilance dhe vlersimi I tyre eshte bere sipas rregullave te percaktura ne ligjin nr.7661 dt 19.01.1993 "Per Kontabilitetin".

Ne funde te vitit 2005 shoqeria "E RGI," sh.p.k. ka te pasqyruar ne bilance ne grupin e kapitaleve te veta ,pervec kapitalit te nenshkruar prej 14 400 000 leke edhe rezerva 50 908 leke si dhe fitimin e vitit 2005 prej 4 549 943 leke.

Shoqeria zoteron nje pasuri ne aktive te qendrushme dhe ne aktive qarkulluse te vertetuar me inventar fizik si per gjendjen e mobiljeve paisjeve iformatike ,mjeteve te trasportit, dhe per gjendjen e mallrave e likujditeteve kerkesave per arketim e te tjera..

Persa me siper kapitalit te nenshkruar te shoqerise mbi bazen e vendimit te asamblese se ortakeve, mbas vertetimit nga ana ime,i shtohet vlera prej 4 600 000 leke.

**Vlera e shtuar ne kapitalin themeltar prej 4 600 000 lekesh eshte e barabarte me fitimet e krijuara e te pa shperndara ose me fitimet e kapitalizuara.**

SI PERFUNDIM : **Une vlersoj se kapitali nenshktuar I shoqerise " ERGI" sh.p.k. rritet per vleren 4 600 000 leke .**
**Mbas rritjes se me siperme kapitali themeltar behet 19 000 000 leke(nentembedhjet milion.), 100 % e tije zoterohet nga ortku i vetem Nuri Balla .**

Tirane me, Maj 2006.

Eksperte Kontabel e Autorizuar
-Lumturi Brahaj

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR LUMTURI BRAHAJ TIRANE

SHOQERA "E R G I." SH.P.K..

**Deklarim i gjendjes financiare (Bilanci)**
Perjudha 1 Janar-31 Dhjetor 2005
**(ne leke)**

**Aktivi**

| Emertimi | Viti | |
|---|---|---|
| | 2005 | 2004 |
| **Aktive qend.te pa trupzuara** | **0** | **0** |
| **-Shpenzime te nisjes** | **0** | **0** |
| **A m o r t i z i m i** | **0** | **0** |
| **Aktive te Qendrueshme te trupzuara** | **6 145 322** | **7 334 636** |
| Toka,troje terrene ,ndertime | 0 | |
| Istalime,makineri e paisje | 6 103 145 | 5 856 695 |
| *Te tjera ne shfrytezim* | 2 871 950 | 2 795 850 |
| *Amortizimi* | **- 2829 773** | **- 1 317 919** |
| **B.Aktive Qarkulluese** | **39 180 202** | **44 713 205** |
| Gjendje inventari ,materjale, | | 0 |
| Kliente | 25 539 525 | 39 210 977 |
| Inventar ekonomik | 89 750 | 0 |
| Te tjera -. | 346 119 | 0 |
| Ortaku | 0 | 0 |
| Likujditete | 13 204 805 | 5 072 763 |
| Shpenzime per tu shperndare | 861 000 | 861 000 |
| **Totali i aktivit** | **46 186 524** | **52 908 831** |

**Pasivi**

| | | |
|---|---|---|
| **Kapitalet e veta** | **19 000 851** | **14 450 908** |
| Kapitali I nenshkruar | 14 400 000 | 100 000 |
| Prime te lidhura me kapitalin | 0 | 0 |
| Rezerva | 50 908 | 10 000 |
| Humbje-Fitim i mbartur | 0 | 8 729 925 |
| Humbje Fitim te Ushtrimit | 4 549 943 | 5 610 983 |
| Provizione per rreziqe | 0 | 0 |
| **Detyrimet** | **27 185 673** | **38 457 923** |
| Detyrimet e kerk.mbi 1 vite | 5 416 856 | 3 931 636 |
| Detyrime te ker.deri ne 1 vite | 21 481 731 | 34 526 287 |
| **Llogari te tjera - dif.konvertimi** | **0** | **0** |
| **Totali i pasivit** | **46 186 524** | **52 908 831** |

***Shenimet e paraqitura ne kete raport jan pjese perberese e deklarimeve.***

EKSPERT KONTABËL E AUTORIZUAR LUMTURI BRAHAJ TIRANË

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Nr. 8112 Rep**




## VERTETIM

Sot me daten 15/6/2006 ne Zyren e Noterise Tirane perpara meje noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht ekspertja kontabel Lumturi Brahaj e cila deklaroi se akti sa siper eshte nenshkruar prej saj me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noterja pasi u binda per identitetin e saj legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.

**NOTERE**